



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo




Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0078642-2/26, dt. 12.01.2026

Mitrovicë



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 51, paragrafi 1, dhe 52 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2009); nenit 3, paragrafi 2, dhe neneve: 4, 5 dhe 6, paragrafi 3, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë; nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; si dhe nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 61, paragrafi 1, nënparagrafi dhe 65 të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 12.01.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

1. Me këtë vendim FORMOHET Komiteti për Politikë dhe Financa në këtë përbërje:
 - 1.1 Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit, nga subjekti politik LDK,
 - 1.2 Majlinda Kurti - nga subjekti politik PDK,
 - 1.3 Igballë Islami - nga subjekti politik PDK,
 - 1.4 Valon Brahimi - nga subjekti politik PDK,
 - 1.5 Erseka Barani - nga subjekti politik LVV,
 - 1.6 Kushtrim Zeneli - nga subjekti politik LVV, dhe
 - 1.7 Visar Syla - nga subjekti politik Guxo.
2. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për:
 - 2.1 Shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik;
 - 2.2 Kornizën vjetore buxhetore dhe atë afatmesme;
 - 2.3 Planin vjetor të Prokurimit;
 - 2.4 Rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat;
 - 2.5 Buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal; si dhe
 - 2.6 Marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.
3. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.
 - 3.1 Në rastet kur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa mungon Kryesuesi, mbledhja kryesohet nga anëtarë të tjerë të komitetit.
4. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve të tjera.
5. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa është 4 vjeçar. Mandati i anëtarëve përfundon me përfundimin e mandatit të Kuvendit të Komunës.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
- 1 x 1 MAP
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- Anëtarëve të KPF-së



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI